



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1426/5 prot.

Datë 08.06.2026

V E N D I M
Nr.759 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.06.2026 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Serdado” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-80420-03-30-2026, me objekt: “Mirëmbajtje e autoambulancave të Spitalit Rajonal Lezhë”, me fond limit 14,286,633.33 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 23.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK në procedurën e sipoërpërmendur të prokurimit.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a, me adresë: Rruga ”Reshit Çollaku”, Godina nr.6/337(në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK me NIPT L01314031G dhe adresë: Rruga e Kavajes, Ndertese 2 kateshe, Kati 2 , Km 6, Tiranë.

Subjekte të interesuar:

Operatori ekonomik “Serdado” SHPK me NIPT J67902524E dhe adresë: Shengjin, Banese 1 Katëshe, Superstrada Lezhë Tiranë, km 2.

Operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK me NIPT L62311016C dhe adresë: Kashar, Yrshek, Rruga Nozllaku, Godine 2 kateshe, Kati 1, Zona Kadastrale 3866,Nr. Pasurie 287/28 Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:**I****Vlerësimi Paraprak**

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2.Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se ankimet janë për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tij duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatori ekonomik ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar.

1.5. Operatori ekonomik ankimes ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

1.6. Ankimesi nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik për ankesën me nr. A/2026/6632 si dhe nr. Protokolli 1426/2026 datë 08.05.2026

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 31.03.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-80420-03-30-2026, me objekt: “Mirëmbajtje e autoambulancave të Spitalit Rajonal Lezhë”, me fond limit 14,286,633.33 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 23.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 23.04.2026, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më datë 30.04.2026, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

Serdado	11,202,870 lekë	300 pikë	Kualifikuar
Auto Manoku Servis	12,000,000 lekë	279 pikë	Kualifikuar
Vilnik Motors	12,939,600 lekë	261 pikë	Kualifikuar
AEE Service	14,200,000 lekë	237 pikë	Kualifikuar
Alstezo	14,000,000 lekë	240 pikë	Kualifikuar

II.4 Në datën 06.05.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 08.05.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6632 si dhe nr. Protokolli 1426/2026 datë 08.05.2026 i operatorit ekonomik “Vilnik Motors” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-80420-03-30-2026, me objekt: “Mirëmbajtje e autoambulancave të Spitalit Rajonal Lezhë”, me fond limit 14,286,633.33 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 23.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me shfuqizimin e vendimmarrjes së komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Serdado” SHPK dhe operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1426/1 prot, datë 08.05.2026.

II.5.2 Autoriteti kontraktor nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr. 1554/13 prot., datë 13.05.2026, protokolluar me tonën me nr.1426/2 prot., datë 14.05.2026, ka dërguar vendimin e KSHA nr.74/2026, datë 13.05.2026, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “Vilnik Motors” SHPK. Referuar vendimit nr.74/2026, datë 13.05.2026 të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj duke argumentuar : [...] *Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas LPP dhe Rregullave të Prokurimit Publik, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimiti, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin konkret, ankimi administrativ i paraqitur nga OE ankimes nuk mund të konsiderohet si ezaurim i formës së ankimit, pasi mungojnë elementët e domosdoshëm ligjore që duhet të përmbajë një ankim administrativ, në kontekstin e prokurimit publik.*

Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, me anë të rubrikës "Kërkesë për informacion OE" nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, në datë 08.05.2026 dërgoi kërkesën për plotësimin e mangësive të konstatuara lidhur me mosparaqitjen e dokumentit bankar, i cili vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën e paraqitur. Pas përfundimit të afatit kohor të përcaktuar në pikën 3 të Nenit 111 të LPP, u konstatua se plotësimi i kësaj mangësie nuk u korrigjua nga ana e Operatorit ekonomik ankimes.

KSHA pas verifikimeve konstaton se Operatori ekonomik ankimes edhe pse i është vënë në dispozicion i gjithë informacioni i nevojshëm ligjor në lidhje me mënyrën dhe formën paraqitjes së ankesës, ai sërish nuk ka mundur që të korrigjojë mangësitë e identifikuar në lidhje me pagesën e tarifës financiare brenda 2 ditëve nga njoftimi.

Sa më sipër argumentuar, KSHA gjykon se për sa kohë, ankesa e paraqitur nga Operatori ekonomik ankimes "VILNIK MOTORS" shpk nuk plotëson kushtet formale, siç është dhe pagesa e tarifës rrjedhimisht kjo ankese duhet refuzuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", (i ndryshuar), si dhe Nenit 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për Shqyrtimin e Ankesave,

VENDOSI

1.Refuzimin e ankesës së paraqitur nga Operatori ekonomik "VILNIK MOTORS" shpk [...].

II.6.Në datën 10.05.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6634 si dhe nr. Protokolli 1435/2026 datë 11.05.2026 i operatorit ekonomik “Vilnik Motors” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-80420-

03-30-2026, me objekt: “Mirëmbajtje e autoambulancave të Spitalit Rajonal Lezhë”, me fond limit 14,286,633.33 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 23.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me shfuqizimin e vendimmarrjes së komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Serdado” SHPK dhe operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1435/1 prot, datë 12.05.2026.

II.6.2. Nëpërmjet sistemit të ankesave, autoriteti kontraktor me shkresën nr. 1554/14 prot., datë 21.05.2026, protokolluar me tonën me nr.1435/2 prot., datë 21.05.2026, ka dërguar vendimin e KSHA nr.77/2026, datë 21.05.2026, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Vilnik Motors” SHPK. Referuar vendimit nr.77/2026, datë 21.05.2026 të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj.

II.6.3. Vendimin e KSHA nr.77/2026, datë 21.05.2026, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Vilnik Motors” SHPK, autoriteti kontraktor e ka përcjellë edhe nëpërmjet shërbimit postar, protokolluar me tonën me nr.1435/3 prot., datë 25.05.2026. Bashkëngjitur vendimi të KSHA nr.77/2026, datë 21.05.2026, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë KPP edhe dokumentat e operatorit ekonomik të shpallur fitues “Serdado” SHPK, për të cilin ngrihen pretendime nga operatori ekonomik ankimues “Vilnik Motors” SHPK.

II.6.4. Me Vendimin e Ndërmjetëm me nr. 711/2026 datë 25.05.2026, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. *Të urdhëroj paraqitjen e dokumentacionit origjinal ose kopje e noterizuar e tyre, nga ana e subjektit “Auto Manoku Servis” SHPK, në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor, të parashikuara në kriteret e vecanta të kualifikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-80420-03-30-2026, me objekt: “Mirëmbajtje e autoambulancave të Spitalit Rajonal Lezhë”, me fond limit 14,286,633.33 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 23.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.*
2. *Ky dokumentacion të paraqitet pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda datës 01.06.2026.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.6.5. Në lidhje me Vendimin e Ndërmjetëm me nr. 711/2026 datë 25.05.2026, nga operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” sh.p.k., nuk është dërguar asnjë informacion.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me ankesën e administruar në datën 08.05.2026 me nr. A/2026/6632 dhe nr.1426/2026 prot, datë 08.05.2026, të operatorit ekonomik “Vilnik Motors” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-80420-03-30-2026, me objekt: “Mirëmbajtje e autoambulancave të Spitalit Rajonal Lezhë”, me fond limit 14,286,633.33 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 23.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara mbi kundërshtimin e vendimmarrjes së komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Serdado” SHPK dhe operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk ka kryer pagesën e tarifës financiare për ankesën e mësipërme, në përputhje me përcaktimet në nenin 111, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Ankimesi është i detyruar t'i bashkëlidhë ankimit dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

3. Nëse mungon ndonjë nga elementet e sipërpërmendura ose formulari nuk është plotësuar në mënyrën e duhur, atëherë autoriteti ose enti kontraktor duhet të vërë në dijeni ankimesin për të plotësuar formularin. Njoftimi mund të bëhet me çdo mjet të mundshëm, përfshirë edhe postën elektronike, dhe në çdo rast dokumentohet. Nëse ankesa nuk korrigjohet brenda 2 ditëve nga njoftimi, ajo vlerësohet si e paparaqitur.

4. Në çdo rast, paraqitja e ankesës shoqërohet me mandatpagesën e bërë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.”

III.1.1. Në gërmën “a” të pikës 2 të nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, është parashikuar se: “2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji”.

III.1.2. Autoriteti kontraktor me shkresën nr. 1554/13 prot., datë 13.05.2026, protokolluar me tonën me nr.1426/2 prot., datë 14.05.2026 ka përcjellë vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nr.74/2026, datë 13.05.2026, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Vilnik Motors” SHPK. Referuar vendimit të KSHA-së, Nr.74/2026, datë 13.05.2026, rezulton se kjo e fundit ka shqyrtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e ankesës së ankimesit si të paparaqitur, për shkak të moskorrigjimit të të metave të ankesës nga operatori ekonomik ankimues.

III.1.3. Referuar pikës 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni thekson, se ligjvënësi ka përcaktuar disa elemente të domosdoshme formale për paraqitjen e ankesës, njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor. Një prej elementeve të domosdoshme për paraqitjen e ankesës është edhe dokumenti bankar, që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën. Ndërsa referuar pikës 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, Komisioni gjykon, se ligjvënësi i ka dhënë një mundësi ankimesve, që të korrigjojnë ankesat e tyre në rast se konstatohet mungesa e një apo më shumë elementeve formale të përcaktuara në pikën 2 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar. Me anë të kësaj mundësie, ligjvënësi ka dashur të përcjellë frymën, se nuk mund t’i refuzohet e drejta e ankimit subjekteve që pretendojnë se dëmtohen ose rrezikojnë të dëmtohen nga një vendimmarrje e autoritetit kontraktor në mënyrë apriori, vetëm për shkak të disa mungesave formale, të cilat mund të korrigjohen lehtësisht brenda një afati të arsyeshëm, që nuk cenon parimin e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik. Bazuar në dispozitën e mësipërme, për të konstatuar mungesat lidhur me elementet formale të ankesës, si dhe për të vënë në dijeni ankimesin lidhur me mungesat e konstatuara, është detyrim i autoritetit kontraktor, i cili duhet të njoftojë menjëherë ankimesin me çdo mjet të mundshëm, duke i lënë 2 ditë kohë për të korrigjuar elementet e domosdoshme formale të ankesës.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të depozituar në KPP, vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave Nr.74/2026, datë 13.05.2026, lidhur me ankesën e operatorit ankimues “Vilnik Motors” SHPK, rezulton, se autoriteti kontraktor ka zbatuar përcaktimet e bëra nga ana e ligjvënësit në pikën 3 të nenit 111 të LPP-së, i ndryshuar, duke respektuar hapat proceduralë që parashikon kjo dispozitë ligjore, sepse përmes sistemit të ankesave elektronike më datë 08.05.2026, autoriteti kontraktor i ka kërkuar operatorit ekonomik “Vilnik Motors” SHPK, ndreqjen e të metave të ankesës, në rastin konkret kryerjen e pagesës së tarifës për ankesën e paraqitur.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të caktuara në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga përgatitja e ofertës, shqyrtimi i ofertave, ankimi, si dhe mundësia për të korrigjuar mangësitë lidhur me elementet e domosdoshme formale të ankesës, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike.

Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme, lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni Prokurimit Publik, konstaton se autoriteti kontraktor ka njoftuar (më datë 08.05.2026) operatorin ekonomik ankimues përmes SAE, në lidhje me korrigjimin e mangësive të konstatuara në lidhje me elementet formale të ankesës, konkretisht pagesës së tarifës së ankesës. Sa më sipër, konstatohet se ankimuesi nuk ka paguar tarifën financiare të ankesës në përputhje me përcaktimet e pikës 2 të nenit 111 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar duke mos plotësuar kështu një prej elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës.

Sa më sipër argumentuar, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se, për sa kohë ankesa me nr. A/2026/6632 dhe nr.1426/2026 prot, datë 08.05.2026, paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Vilnik Motors” SHPK nuk plotëson kushtet formale, siç është pagesa e tarifës, duhet refuzuar.

III.2.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, të parashtruara nëpërmjet ankesës me nr.A/2026/6634 si dhe nr. Protokolli 1435/2026 datë 11.05.2026, për shfuqizimin e vendimmarrjes së komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin e ndërmjetëm Nr. 711/2026 datë 25.05.2026 i kërkoi operatorit ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK paraqitjen e dokumentacionit origjinal ose kopje e noterizuar e tyre, në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor, të parashikuara në kriteret e vecanta të kualifikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi për të cilat ngrihen pretendime nga ankimuesi. Në lidhje me vendimin e ndërmjetëm Nr. 711/2026 datë 25.05.2026 nga operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK nuk është dërguar asnjë informacion/dokumentacion. Operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit të kërkuar, si dhe brenda çdo afati të arsyeshëm ligjor. Referuar pikës 1 të nenit 82 të ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet shprehimisht “1. Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj dhe pikës 4 të nenit 94 “4. Procedura deklarohet e braktisur pa një vendim përfundimtar për çështjen, në qoftë se pala e interesuar, për fajin e saj, ka qenë pasive gjatë afatit për përfundimin e procedurës administrative të parashikuar në nenin 91 të këtij Kodi”, barra e provës i përket operatorit ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK, si palë e interesuar në këtë proces, i cili ka dështuar për të sjellë dokumentacionin origjinal ose kopje e noterizuar e tyre, në përmbushje të kërkesave të autoritetit kontraktor, të parashikuara në kriteret e vecanta të kualifikimit të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Në këto kushte, duke qenë se operatori ekonomik “Auto Manoku Servis” SHPK, si palë e interesuar, ka qenë pasiv dhe jobashkëpunues në dhënien e informacionit të kërkuar, Komisioni nuk do të marrë në shqyrtim pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Vilnik Motors” Shpk. Konkretisht, Komisioni konstaton se pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Vilnik Motors” SHPK mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Auto Manoku Servis” sh.p.k,

janë pretendime që nuk mund të verifikohen nga burime të hapura, por është detyrë e operatorit ekonomik “Auto Manoku Servis, që të sjellë dokumentacionin provues. Operatorit ekonomik “Auto Manoku Servis, ka marrë dëgjimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Serdado” SHPK me arsyen se nuk plotëson kriterin 2.3.2, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

Sa më sipër, në kushtet ku KPP është treguar proaktive në kërkim të informacionit të deklaruar në Formularin Përmbledhës të vetdeklarimit në SPE, për tu dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik “Auto Manoku Servis” sh.p.k., ndërsa ky i fundit refuzoi bashkëpunimin me KPP, duke bërë të pamundur verifikimin e deklartave të bera në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, pra ky i fundit ka dështuar të provojë që përmbush kriteret e vecanta të kualifikimit, për të cilat ngrihen pretendime nga ankimuesi për mospërmbushje, KPP gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të skualifikojë këtë operator ekonomik nga procedura e prokurimit objekt ankimi.

III.3.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Vilnik Motors” SHPK, mbi kundërshtimin e Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Serdado” SHPK me arsyen se nuk plotëson kriterin 2.3.2, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e vecanta për kualifikim” pika 2.3 Kapaciteti teknik,, pika 2.3.2 autoriteti kontraktor ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë përmbushjen e kriterit si më poshtë:

2.3.2 *Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të të cilit të ketë minimalisht 6 (gjashtë) punonjës sipas profileve të mëposhtme:*

- a) 1 (një) përgjegjës Teknik, i cili duhet të jetë Inxhinier mekanik ose Teknik, mekanik transporti.
- b) 1 (një) motorrist
- c) 2 (dy) xhenerikë
- d) 1 (një) pompist
- e) 1 (një) elektroauto

Në lidhje me punonjësin në pikën (a), duhet të paraqitet:

- diploma e arsimit të lartë dhe/ose dëshmia e aftësisë profesionale sipas Ligjit Nr.15/2017, “Mbi arsimin dhe formimin profesional”, i ndryshuar.

- kontratë pune (të vlefshme) si përgjegjës Teknik, dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër.

Për secilin prej punonjësve në pikat b, c, d, e, më sipër duhet të paraqitet:

- kontratat e punës, e vlefshme, ku të specifikohet pozicioni si motorist, xhenerik, pompist, elektroauto dhe të ketë kohëzgjatje jo më pak se afati i marrëveshjes kuadër.
- Dëshmitë e aftësisë profesionale, për secilin punonjës, sipas Ligjit Nr.15/2017, “Mbi arsimin dhe formimin profesional”, i ndryshuar.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik Serdado shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Shtojcën 10 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” , sipas së cilës në Pjesën e III, Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, B Deklaratë, Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme(nëse kërkohen), operatori ekonomik “Serdado”shpk deklaroi, si më poshtë:

B: DEKLARATE	
Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)	
Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u>
Unë kam punonjës të nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	Po [☒] Jo [☐] Nëse, po, numri i punonjësve: 7 (shtatë) Profili i punonjësve Pika 2.3.2 e DST si më poshtë: a. [REDACTED] – Përgjegjës Teknik, Inxhinier Mekanik, Mekanik Transporti b. [REDACTED] – Motorrist c. [REDACTED] – Xhenerik c.e [REDACTED] – Xhenerik d. [REDACTED] – Pompist e. [REDACTED] i - Elektroauto



III.3.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.3.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” i ligjit nr. 162/2022 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.3.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.3.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohej për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohej të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t'i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij .

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.3.7. Në ligjin Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 3 të tij përcakton se: “Arsimi dhe formimi profesional ka për mision: a) të zhvillojë kompetenca personale e profesionale të nevojshme, si dhe shprehi e kompetenca të tjera të diversifikuara, që pasqyrojnë preferencat dhe nevojat e veçanta të punëdhënësve për të siguruar mirëqenie sociale dhe zhvillimin ekonomik; b) të ofrojë arsim dhe formim profesional në përputhje me nivelin e zhvillimit të shkencës e të teknologjisë, me kërkesat e tregut të punës në ndryshim të vazhdueshëm, si dhe me kulturën e traditën kombëtare; c) të sigurojë përputhshmëri ndërkombëtare të dokumenteve certifikuese të lëshuara.” .

Ndërsa në pikën 17 të nenit 4 të po këtij ligji parashikohet se: “Certifikatat/dëshmitë/diplomat” janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të lëshuara nga një organ certifikues, të cilat regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit, sipas një procedure e standardi të paracaktuar”.

III.3.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor

përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.3.9. Referuar kriterit 2.3.2, në lidhje me disponimin e personelit teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, Komisioni konstaton, se kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, si dhe dorëzimit të dokumentave si kontratat e punës dhe dëshmitë e aftësisë profesionale për secilin punonjës, sipas Ligjit Nr.15/2017, "Mbi arsimin dhe formimin profesional", i ndryshuar përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit.

Për plotësimin e kriterit në lidhje me disponimin e personelit teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, operatori ekonomik "Serdado" SHPK ka dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku në pjesën e tretë të tij *Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit B Deklaratë "Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)"*, ka deklaruar punonjësit, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, sikurse pasqyrohet në pikën III.3.2 të këtij vendimi, e më konkretisht z. Sh.M - përgjegjes teknik, z.A.F - motorrist, z. A.N - xhenerik, z. E.S – Xhenerik, z. K.M – pompist, z. K.D - Elektroauto. Referuar kriterit të sipërcituar dokumentacioni i nevojshëm për këtë fazë është dorëzimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, i cili është dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ofertues, duke deklaruar punonjësit në përputhje me kriterin e kualifikimit.

III.3.9.Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se, si ofertues i renditur në vend të parë në procedurën e prokurimit objekt ankimi, operatori ekonomik "Serdado" shpk ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dokumentet provuese, në funksion të vetëdeklarimeve të bëra, sipas parashikimeve të pikës 6 të nenit 26 "*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, dokumentacioni i cili është përcjellë nga autoriteti kontraktor në KPP me shkesën nr.1554/15 prot, datë 22.05.2026, protokolluar me tonën me nr.1435/3 prot., datë 25.05.2026.

Nga shqyrtimi i materialit të paraqitur si më sipër cituar, si dhe nisur nga pretendimet e ankimesit sa i takon dëshmitë të aftësisë profesionale sipas Ligjit Nr.15/2017, "Mbi arsimin dhe formimin profesional", i ndryshuar për secilin prej punonjësve në pikat B, C, D, E, të kriterit 2.3.2 konstatohet se nga operatori ekonomik "Serdado" shpk, është dorëzuar në përmbushje të kriterit 2.3.2 dokumentacioni i poshtëshënuar:

Për punonjësin me profil **motorrist** është paraqitur dëshmi kualifikimi në emër të z. A.F, lëshuar nga shkolla mekanike bujqësore 2 vjecare Durrës.

Për punonjësin me profil **xhenerik** është paraqitur Çertifikatë, në emër të z.A.N për përfundimin e kursit të formimit profesional për “Mekanik Automjetesh”, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik nr.1 , Tiranë.

Për punonjësin me profil **xhenerik** është paraqitur dokument në gjuhën greqisht, në emër të z.E.S, me datë lëshimi 27.06.2012.

Për punonjësin me profil **pompist** është paraqitur Çertifikatë, në emër të z. K.M për përfundimin e kursit të formimit profesional për “Pompist”, lëshuar nga Qendra e Formimit Profesional –ASHP, Tiranë.

Për punonjësin me profil **elektroauto** është paraqitur Çertifikatë, në emër të z K.D për përfundimin e kursit të formimit profesional për “Elektroaut ”, Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik nr.4 , Tiranë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Vilnik Motors” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Serdado” SHPK me arsyen se nuk disponon Dëshmitë e Aftësisë Profesionale për secilin punonjës, sipas Ligjit Nr.15/2017, *”Mbi arsimin dhe formimin profesional”*, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, nga ana e operatorit ekonomik “Serdado” SHPK në përmbushje të kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.2 sa i takon certifikimit të 5 punonjësve me profilet përkatësisht 1 motorist, 2 xhenerik, 1 pompist, 1 elektroauto, ka paraqitur certifikimet e sipërcituara.Nga shqyrtimi i këtyre certifikimeve Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se katër prej këtyre certifikimeve janë sipas kërkesës së përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor e për rrjedhojë dokumentacioni i paraqitur vërteton, se punonjësit z.A.F - motorist, z. A.N - xhenerik, z. K.M - pompist, z. K.D - Elektroauto disponojnë kualifikimin përkatës. Ndërsa sa i përket dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Serdado” SHPK për z. E.S – Xhenerik, Komisioni vlerëson se ky dokumentacion nuk është sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, nga ana e operatorit ekonomik “Serdado” SHPK në përmbushje të kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.2 sa i takon certifikimit për njërin nga punonjësit me profil *xhenerik*, referuar deklaramentit në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit ka paraqitur një dokument për z. E.S, dokument në gjuhën greqisht. Nga verifikimi i këtij dokumentacioni, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se ky dokument/certifikata e lëshuar për punonjësin E.S nuk hyn në kuadrin rregullator të Ligjit nr. 15/2017 *“Për arsimin dhe formimin profesional”*, pasi institucioni që ka lëshuar këtë dokument nuk funksionon si ofrues i licencuar i Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në Shqipëri. Në dokumentat standarte të tenderit është kërkuar shprehimisht që për punonjësin me profil *xhenerik* kërkohet Dëshmi e aftësisë profesionale, sipas Ligjit Nr.15/2017, *”Mbi arsimin dhe formimin profesional”*, i ndryshuar. Sipas Ligjit nr. 15/2017, certifikatat zyrtare të formimit profesional lëshohen vetëm nga ofrues (shkolla ose qendra të formimit profesional) që janë të licencuara nga ministria përgjegjëse dhe të miratuara nga AKAFPK dhe AKPA. Këto certifikata lidhen me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve. Po ashtu, në pikën 4.7 të dokumentave standarte të tenderit është përcaktuar gjuha në të cilën mund të hartohen ofertat, që në rastin konkret është përcaktuar shqip.

Referuar dokumentit së dorëzuar nga operatori ekonomik Sedado shpk, si dëshmi për 1 punonjës me profil *xhenerik* si dhe kriterit 2.3.2, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ky

operator ekonomik nëpërmjet certifikatës së dorëzuar nuk përmbush kriterin e vecantë të kualifikimit, pikën 2.3.2 të shtojcës 9, të dokumentave të tenderit. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor, e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues lidhur me këtë pikë qëndron pjesërisht.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Vilnik Motors” SHPK, mbi kundërshtimin e Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Serdado” SHPK *me arsyen se nuk plotëson kriterin 2.3.7*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e vecanta për kualifikim” pika 2.3 Kapaciteti teknik,, pika 2.3.7 autoriteti kontraktor ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë përmbushjen e kriterit si më poshtë:

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokument provues për dorëzimin e vajrave të përdorura te subjekti që është pajisur me leje për transportimin, rikuperimin dhe/ose asgjësimin e VP-ve në përmbushje të VKM 765 datë 07.11.2012 “Per miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorur”.

III.4.2.Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik Serdado shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë shërbimi nr. 128, datë 07.01.2026 me palë: Ofrues shërbimi “Green World” SHPK dhe Përfitues, “Serdado” SHPK, objekt i së cilës është ofrimi dhe kryerja e shërbimit të mbledhjes , transporetit dhe asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme, vajrave lubrifikantë të djegur, skrapit, baterive të plumbit, si dhe pjesëve të skaduara elektike dhe elektronike, me afat 1 vjeçar, me të drejtë rinovimi.
- Licencë kategoria III.2.B për grumbullimin , transportimin , ruajtjen e mbetjeve të llojeve të ndryshme të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, ushqimore dhe ujrave të ndotur, lëshuar në emër të “Green Eorld” SHPK.

III.4.3.Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është:

- “a) të rrisë eficiencyn dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.4.4. Neni 3 Parime të përgjithshme parashikon “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

III.4.5. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 2 e 6 të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se:

“2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve..

6 Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

III.4.6. Referuar nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik” përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji..”.

III.4.7. Neni 663 “Konditat e nevojshme për lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratës” i Kodit Civil parashikon shprehimisht: “Konditat e nevojshme për qenien e kontratës janë: pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin, shkaku i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi, objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji.

Ndërsa neni 664 “Lidhja e kontratës” i Kodit Civil parashikon: “Kur kontrata përmban vetëm detyrimin e propozuesit, pritësi mund ta refuzojë propozimin Brenda afatit të caktuar, ose që rrjedh nga natyra e marrëveshjes. Në mungesë të një refuzimi të tillë, kontrata quhet e lidhur.

III.4.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.4.9. Në dokumentet e tenderit , kriteri 2.3.7 është kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik të paraqesë dokument provues për dorëzimin e vajrave të përdorura te subjekti që është pajisur me leje për transportimin, rikuperimin dhe/ose asgjësimin e vajrave të përdorur, në përmbushje të VKM nr.765, datë 07.11.2012 “Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura”. Komisioni konstaton se në përmbushje të kriterit 2.3.7 të kapacitetit teknik, operatori ekonomik “Serdado” SHPK ka paraqitur dokumentacionin e përmendur në pikën III.4.2 të këtij vendimi e më konkretisht kontratë shërbimi nr. 128, datë 07.01.2026 me palë: Ofrues shërbimi “Green Eörd” SHPK dhe Përfitues, “Serdado” SHPK, objekt i së cilës është ofrimi dhe kryerja e shërbimit të mbledhjes, transportit dhe asgjësimit të mbetjeve të rrezikshme, vajrave lubrifikantë të djegur, skrapit,

baterive të plumbit, si dhe pjesëve të skaduara elektike dhe elektronike, me afat 1 vjecar, me të drejtë rinovimi, me nënshkrim vetëm të palës ofruese si dhe Licencë kategoria III.2.B për grumbullimin, transportimin, ruajtjen e mbetjeve të llojeve të ndryshme të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, ushqimore dhe ujrave të ndotur, lëshuar në emër të “Green Eorld” SHPK. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Serdado” SHPK rezulton se kontrata e depozituar është nënshkruar vetëm nga subjekti ofrues i shërbimit, ndërsa mungon nënshkrimi i palës përfituese. Për pasojë, dokumenti nuk provon në mënyrë të plotë pranimin e kontratës dhe ekzistencën e një marrëdhënieje juridike kontraktore ndërmjet palëve. Referuar nenit 663 të Kodit Civil, kontrata quhet e lidhur kur palët kanë shfaqur në mënyrë reciproke vullnetin e tyre, duke u dakortësuar për të gjitha kushtet thelbësore të saj. Gjithashtu, neni 664 i Kodit Civil parashikon se kontrata mund të lidhet me anë të ofertës dhe pranimin. Në rastin konkret, kontrata e paraqitur është nënshkruar vetëm nga ofruesi i shërbimit, ndërsa mungon nënshkrimi i palës përfituese, çka nuk lejon verifikimin e shfaqjes reciproke të vullnetit të palëve për lidhjen e marrëdhënieje kontraktore. Po ashtu operatori ekonomik Serdado shpk nuk ka paraqitur dokumentacion tjetër mbështetës, si procesverbale dorëzimi, formularë shoqërues të mbetjeve, vërtetime nga subjekti i licencuar, fatura apo dokumente të tjera që të provojnë në mënyrë të qartë dhe të verifikueshme dorëzimin e vajrave të përdorura te një subjekt i autorizuar. Sa më sipër, Komisioni gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik Sedado SHPK nuk plotëson kriterin e kualifikimit të kërkuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.7 të dokumentave të tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues lidhur me këtë pikë qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Vilnik Motors” SHPK., për skualifikimin e operatorit ekonomik “Serdado” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, për sa kohë gjendja faktike e juridike e operatorit ekonomik “Serdado” SHPK referuar arsyetimit të bërë në pikën III.3.9 e III.4.9 të këtij vendimi do të ndryshojë nga e kualifikuar në të skualifikuar, duke përmbushur kështu interesin e ankimuesit, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Vilnik Motors” SHPK me nr. A/2026/6632 si dhe nr. Protokolli 1426/2026 datë 08.05.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-80420-03-30-2026, me objekt: “Mirëmbajtje e autoambulancave të Spitalit Rajonal Lezhë”, me fond limit 14,286,633.33 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 23.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara..
 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” me nr. A/2026/6634 si dhe nr. Protokolli 1435/2026 datë 11.05.2026 SHPK në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.
 3. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë operatorin ekonomik “Auto Manoku Service” SHPK dhe operatorin ekonomik “Serdado” SHPK sipas konstatimeve të shprehura në këtë vendim.
 4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

